



# IDENTITETI I KOMUNITETIT ROM DHE ANTI-DISKRIMINIMI





# IDENTITETI I KOMUNITETIT ROM DHE ANTI-DISKRIMINIMI



**Dita Ndërkombëtare romë** festohet për nder të takimit të parë Ndërkombëtar të përfaqësuesve të Romëve që është mbajtur në 8 prill 1971 në Londër, me pjesëmarrjen e 22 shteteve anëtare. Vlen të përmendet se pjesë e këtij kongresi ishte edhe aktivisti rom nga Prizreni, Albanologu i njohur **Nysret Seharsoj** ku për nder të kësaj, sot lagjja më e vjetër e romëve në Kosovë, Terzimahalla në Prizren mban emrin Nysret Seharsoj.

Delegatët e kësaj Konference kontribuan zyrtarisht në themelimin e Organizatës së parë Ndërkombëtare Romë **IRU**. Përmes kësaj Konference u vendos **flamuri rom** me ngjyrën e gjelbër që simbolizon tokën, ngjyrën bojëqielli që simbolizon qiellin dhe me rrotën e kuqe (e ashtëquajtur Chakra e Ashok-ut) si simbol i vendlindjes së Romëve (Indisë), e cila simbolizon zjarrin, lëvizjen dhe progresin.

**Himni rom Gelem Gelem** (shkuem – shkuem) dhe përcaktimi i emrit **rom** do t'i jepte fund të gjitha epiteteve të tjera diskriminuese si: gipsy, cigan, magjup etj., dhe do të ndihmonte në krijimin e vetëbesimit të ri për të gjithë romët mbarë botës. Në këtë kongres u arrit një bashkëpunim me OKB-në (Organizatën e Kombeve të Bashkuara), posaçërisht me UNESCO-n i cili kujdeset edhe në ditët e sotme për trashëgiminë kulturore ndërkombëtare.

Motoja “Opre Roma!” u bë besimi politik i Lëvizjes Rome dhe luftimi i saj për drejtësi & barazi sociale.

Në vitin 1976, në qytetin Chandigar të Indisë është formuar Instituti i Parë i Romologjisë, ku është publikuar edhe revista e parë e titulluar “Rroma”. Në po këtë vit dhe në po këtë qytet është mbajtur edhe festivali i Parë Botëror Romë. Delegatët romë që ishin pjesë e këtij mbajtën takimin e parë me kryeministren e Indisë, znj. Indira Ghandi, e cila midis të tjerash deklaroi “Romët janë fëmijët e harruar të Indisë”. Zonja Ghandi, festivalin e ka hapur me fjalën “Mirë se erdhët në vendlindje”.

OKB-ja në rekomandimet e shtatorit të vitit 1977, i njeh Romët si grup etnik specifik, si një nevojë për parandalimin e diskriminimit ndaj kësaj pakice.

Sot, Romët janë të përfaqësuar në OKB përmes statutit të vëzhguesit, i cili ushtrohet nga Unioni Ndërkombëtar Rom (IRU). Romët gjithashtu janë të përfaqësuar në Këshillin e Europës dhe institucionet tjera Europiane si (Komisioni European, Parlamenti European, etj.), përmes Forumit European të Romëve dhe Deputetëve Romë në Parlamentin European.

## Historia dhe Romët në Kosovë

Mungesa e të dhënave të shkruara ka bërë që origjina e popullit rom për shumë kohë të ishte e paqartë. Analiza gjuhësore e cila filloi në fundin e shekullit të tetëmbëdhjetë dhe e konfirmuar nga gjuhëtarë të shquar të shekullit të XIX, ka qenë prova e parë e padiskutueshme për origjinën të popullatës rome.



Një pjesë e shkurtër e Kitab al-Jamini (libri i dinastisë së Jamineve), shkruar nga kronisti Abu Nars Al 'Utbi, përshkruan midis të tjerash, sulmet e Mahmud të Ghaznisë, një pushtues i ardhur nga Ghazni (sot në Afganistan) i cili në dimrin 1018-1019, më 8 Shaban (ose 20 dhjetor) sulmon Kanauxhin për të zaptuar popullsinë ku jetonin atëherë 53 000 banorë, për t'i shitur banuesit si skllevër e për të plaçkitur pasurinë e tempujve dhe kështu filloi egzodi i romëve. Këta njerëz u blenë nga pronarë të Horasanit e të Irakut lindor.

Origjina indiane dhe “rruga për në Evropë” përmes Persisë, Armenisë dhe Azisë së Vogël si pjesë e perandorisë bizantine është e pakontestueshme, në radhë të parë për shkak të dëshmive gjuhësore dhe duke u bazuar në hulumtime të lingvistëve dhe hulumtuesve si dr. Marcel Courthiade dhe dr. Ian Hancock dhe të tjerë.

Romët në Ballkan kanë ardhur në shekullin katëmbëdhjetë (14), me ardhjen e Turqëve në Ballkan. Ekziston një dokument serb sipas të cilit Mbreti Stefan IV në vitin 1348 ia kishte dorëzuar manastirit të Prizrenit disa rrobaqepës, farkëtar, punues të shalave, dhe disa “C'ngari”. Ishte thënë se këta të fundit ishin “Ciganë”. Sidoqoftë, duket më bindëse se thjesht një zanat tjetër ishte në pyetje: në gjuhën mesjetare serbe, “c'ngar” kishte kuptimin e “këpuctarit”.

Si çdokund në Evropë, ata ishin vegël e pastrimit etnik, fëmijët e tyre ishin rrëmbyer, dhe punonin nën dhunë dhe presion. Shumë herë ishin të varur apo dëbuar, të dalluar apo të ndarë nga shoqëria, të etiketuar, sterilizuar dhe duke jetuar në skllavëri për një kohë të gjatë.

Romët njihen si një nga pakicat etnike më e vjetra, më e madhe dhe më e pafavorizuar e Evropës. Këshilli i Evropës vlerëson të ketë rreth 10 deri në 12 milionë romë në Evropë. Në Kosovë mendohet se mund të jenë rreth 8.000 - 20.000 romë.

Emancipimi i romëve në Kosovë ka filluar gjatë viteve '60 të shekullit të kaluar, kryesisht përmes aktiviteteve kulturore. Romët nga Kosova janë të njohur si aktivistë të denjë dhe inicues të shumë proceseve pozitive për komunitetin dhe shoqërinë.

<sup>1</sup> <https://milibutka.wordpress.com/2016/10/26/rromet-prejardhja-e-tyre-indiane-dr-marcel-courthiade/>

<sup>2</sup> [https://www.coe.int/t/dg4/education/roma/Source/FS2/2.0\\_arrival-europe\\_albanian.pdf](https://www.coe.int/t/dg4/education/roma/Source/FS2/2.0_arrival-europe_albanian.pdf)

## Himni Rom


“Gelem, Gelem” u propozua për himn zyrtar të romëve në Kongresin e parë të Romëve në Londër, 1971. Teksti në gjuhën Romë ishte shkruar nga Zharko Jovanović gjatë Kongresit të vitit 1971, pas një melodie tradicionale.

### GELEM, GELEM

*Gelem, gelem, lungone dromensa  
Maladilem baxtale Romensa  
A Romale katar tumen aven,  
E carensa baxtale dromensa?  
A Romale, a Čhavale  
Vi man sas ek bari familija,  
Murdadas la e kali legija  
Aven mansa sa lumnijake Roma,  
Kaj putajile e romane droma  
Ake vrijama, ušti Rom akana,  
Men khutasa mišto kaj kerasa!  
A Romale, a Čhavale*

### UDHËTUAM, UDHËTUAM

*Udhëtuam, udhëtuam rrugë të gjata,  
dhe takuam romë të lumtur.  
O Romë, prej nga erdhët,  
me tenda në rrugët e lumtura?  
O Romë, o shokë Romë  
Një herë pata një familje të madhe  
Legjioni i Zi I vrau  
Tani ejani, të gjithë Romët e botës  
Sepse rrugët e romëve janë hapur  
Tani është koha, tani ngrihuni Romë,  
Do të ngrihemi lart nëse veprojmë!  
O Romë, o shokë Romë*



## Gjuha Rome

Analizat gjuhësore kanë arritur të përcaktojnë që gjuha rome bën pjesë në familjen indo-evropiane dhe përafrohet me dialektet që vijnë nga veri-perëndimi i Indisë. Romishtja është ruajtur mirë dhe flitet në të gjithë botën në dialekte të ndryshme edhe pse ka huazuar shumë fjalë nga gjuhët e vendeve ku jetojnë.



Vitet e fundit shumë studiues kanë punuar për ta standardizuar gjuhën Rome duke prodhuar abetare dhe fjalorë. Në vitin 1979, Ian Hancock, lingvisti rom nga Anglia publikon broshurën moderne të lingistikës rome “Romani sociolinguistics”. Takimi i parë serioz për gjuhën rome është mbajtur në kongresin e katërt të IRU-së me miratimin e Rezolutës 7/1990 për gjuhën Rome në Warshav (07.04.1990) ku është miratuar abeceda e dr. Marcel Courthiade. Ndërsa, më 1986, Shaip Yusuf ka publikuar gramatikën e parë narrative rome, një kombinimi i dialekteve arli dhe gurbeti (xhambazi). Më 1992 prof. Ibrahim Elshani në bashkëpunim me aktiviste romë nga Prizreni ka adaptuar abeceden rome e njohur si “abeceda e prizrenit” e cila përdoret në literaturë dhe mediat rome në Kosovë.

Gjuha rome në Kosovë shprehet me dy dialektet kryesore: dialekti **Arli** dhe ai **Gurbet**. Nje pjesë e vogël e romëve në vendet rurale të pjesës qendrore në Kosovë (Obiliq, Vushtri) e përdorin dialektin **Bugurgji**.

Dialekti “**arli**” vjen nga fjalët Jerli ose Erli që në gjuhën turke do të thotë “vendor” dhe përfshinë të folurit e Ballkanit, i cili haset në Kosovë (Prizren, Prishtinë, Gjilan, Ferizaj), Bosne, Serbi pa Vojvodinën, Maqedoni e Veriut, Bullgari, Turqi, Greqi dhe Shqipëri.

Dialekti “**gurbet**” flitet nga romët të cilët quhen Gurbet dhe që kryesisht janë në mërgim. Gurbetët njihen edhe si Xhambaz, Gabel dhe Qergarë. Ky dialekt përdoret në Kosovë (Pejë, Mitrovicë, Gjakovë), Mali të Zi, Serbi, Bosnje, Kroaci, Slloveni, numër i vogël në Maqedoni Veriore, Itali, Shqipëri, Turqi dhe vendet e Evropës veriore.

Në evropën qendrore dhe veriore sipas grupeve, romët flasin dialekte si: *llovari, kallderash, kallo, sinti, resande, haladitcka, ruska roma...*

Gjuha rome në shtete të ndryshme të Europës është e përfaqësuar në institucione arsimore përmes mësimin në shkolla fillore dhe të mesme, në Universitete përmes katedrave të Romologjisë, në institucione lokale dhe media.

Në Kosovë, gjuha rome shkruhet në libra dhe në revista, teatri rom, media (media publike dhe lokale) dhe zbatohet në mësimin fakultativ të gjuhës rome në shkollat fillore në Prizren. Në komunën e Graçanicës (2016) gjuha rome është gjuhë në përdorim zyrtar dhe në komunën e Prizrenit (2022) është gjuhë në përdorim zyrtarë/traditional.

## Kultura dhe Tradita Rome

Tradita Rome ka qenë mjeti më i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit etnik. Transmetimi i traditave dhe kulturës është bërë nëpërmjet gojëdhënave nga një brez në tjetrin. Zakonisht, romët kanë jetuar gjithmonë në komunitete të vogla të karakterizuara me një solidaritet të fortë mes anëtarëve: të vjetrit që kujdeseshin nga brezi i ri. Kultura rome ka inkurajuar gjithmonë një distancë sociale mes romëve dhe jo-romëve, të ashtuquajtur gaxhe, dhe si pasojë nuk janë përzier me popullsitë lokale.



Veshja luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit. Janë veshjet e grave që mbartin dhe ruajnë karakteristikat tradicionale. Tradicionalisht, gruaja rome mbart një fund të gjatë, i formuar nga disa shtresa dhe ngjyra të ndritshme, flokë të gjatë, vathë të mëdha dhe në bazë të pasurisë, bizhuteri që bien shumë në sy dhe të kushtueshme. Gjithmonë, duke ju referuar traditës, gratë e martuara duhet të mbajnë një shami koke, nga ana tjetër burrat nuk kanë veshje tradicionale, por shpesh veshin rroba shumëngjyrëshe, kapele dhe mustaqe të gjata.

Përdorimi i ngjyrave të forta në veshjet e tyre konsiderohet si fatsjellës. Sot, të vishesh në mënyrë tradicionale rrit rrezikun e shikimit ndryshe dhe shpesh të diskriminohesh. Ky lloj diskriminimi dëmton më shumë gratë rome sepse veshjet tradicionale rome tërheqin shumë vëmendje dhe bien më në sy se veshjet e meshkujve. Modernizimi shoqëror ka bërë që romët në shumë vende të humbin interesimin për veshjet e tyre tradicionale.

Romët janë të njohur në fusha të ndryshme të artit si: pikturë, skulpturë, botime të përrallave tradicionale, folklorike, etj. Muzika tradicionale Rome është ndoshta pjesa më e njohur e kulturës Rome. Muzika e tyre ka influencuar kompozitorët e muzikës klasike si Franz Liszt dhe Johannes Brahms. Violina, kitara dhe klarineta janë instrumentet e preferuara të muzikantëve Romë.



Kërcimi tradicional një tjetër element i rëndësishëm i kulturës Rome, ka ruajtur elemente nga India ashtu sic edhe ka përfshirë elemente nga kulturat e vendeve në të cilat Romët kanë jetuar. Flamengo përfaqëson shembullin më të dukshëm të kontributit të Romëve në stilin e përgjithshëm të kërcimeve.

Romët kanë shkëlqyer edhe në punime artizanale si në punimin e metalit, qëndisjen dhe gdhendjen e bizhuterive. Me ardhjen e Osmanijve në Ballkan, ata i përdornin romët për përpunimin e rrobave mbrojtëse, që ishte edhe arsye që ata mos të ngacmohen nga të tjerët. Përveq farkatarisë, romët njihen edhe si muzikantë, xhambaza me kuaj, bujqë, arpunues, teneqexhi, nallban, këpuctar etj. Sot romët kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë dhe janë të njohur si biznesmenë të mirë.



Edhe pse kultura e tyre njih elemente karakteristike, sa i përket besimit fetar gjithmonë kanë përqafuar besimin fetar të vendit ku ata jetojnë.

## DATAT E RËNDËSISHME TË ROMËVE

- **27 janari** – Dita Ndërkombëtare e përkujtimit të Holokaustit

Gjatë periudhës 1936-1945 nazistët filluan persekutimin sistematik të romëve, që kulmoi me vrasjen e 500,000 deri në 1,500,000 romëve në atë që quhet Porajmos, Holokausti i Romëve. Në vitin 2005 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë që shpallte 27 janarin, si Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit në nderim të viktimave të Holokaustit. Viktimat ishin kryesisht hebrenj, rom, rusë dhe polakë.

- **8 prilli** – Dita Botërore e Romëve

Më 8 Prill të vitit 1971 në Londër është mbajtur Kongresi i Parë i Romëve ku është formuar Organizata e Parë Ndërkombëtare rome "International Romani Union". Në këtë Kongres janë marr tre vendime shumë të rëndësishme: Hymni i romëve (Gelem gelem), flamuri i romëve dhe emërtimi i popullit rom me emrin Rom. Në këtë takim historik pjesëmarrës ishte edhe prof. Albanolog nga Prizreni, Nysret Seharsoj.

- **16 maji** – Dita e Rezistencës Rome në Kampin Aushvic

Kujtohen dhe nderohen heronjtë e popullit rom. Rreth 6000 romë, burra, gra dhe fëmijë të burgosur në kampin Aushvic-Birkenau, me datën 16 maj të vitit 1944, i rezistuan planit nazist për t'i shfarosur.

- **2 gushti** – Dita Evropiane e Përkujtimit të Holokaustit për Sinti dhe Romët

Më 2 gusht, në përkujtojmë 4300 sinti dhe romët e fundit (burra, gra dhe fëmijë) në kampin gjerman të përqendrimit nazist Aushvic-Birkenau, të cilët u vranë në dhomat e gazit nga SS (oficerët nazistë) atë natë të 2/3 gushtit të vitit 1944 dhe trupat e tyre u dogjën në gropa, pavarësisht rezistencës së tyre të ashpër. Në kujtim të të gjithë 500,000 Sintit dhe Romëve të vrarë në Evropën e pushtuar nga nazistët, Parlamenti Evropian e shpalli këtë datë Ditën Evropiane të Përkujtimit të Holokaustit për Sinti dhe Romët në 2015.

- **5 nëntori** – Dita Botërore e Gjuhës Rome

Dita Botërore e Gjuhës Rome promovon gjuhën, kulturën dhe arsimin romë. Më 5 nëntor 2008, në Zagreb është prezantuar fjalori i parë rom-kroat dhe kroat-rom i shkruar nga shkrimtari dhe politikani rom Veljko Kajtazi. Gjatë Simpoziumit Botëror për Standardizimin dhe Kodifikimin e Gjuhës Rome, i cili u mbajt nga 3 deri më 5 nëntor 2009 në Zagreb të Kroacisë, Unioni Ndërkombëtar i Romëve dhe Shoqata Kroate e Arsimit Romë "Kali Sara" nxorën një deklaratë ku kërkonin njohjen e 5 Nëntorit si Dita Botërore e Gjuhës Rome në të gjitha vendet ku jetojnë romët. Me këtë rast është shënuar edhe shënimi i parë zyrtar i kësaj date. Vlen të përmendet se nga Kosova nënshkruesi i deklaratës ishte aktivisti dhe gazetari rom, Daut Qulangjiu.

Parlamenti Kroat e njohu zyrtarisht në vitin 2012 dhe me kërkesë të Republikës së Kroacisë në vitin 2015 UNESCO e shpalli 5 nëntorin Ditën Botërore të Gjuhës Rome. Që nga viti 2018, 16 shtete anëtare të Këshillit të Evropës e njohin gjuhën rome si gjuhë të pakicës sipas Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoritetit Rom.




## Festat lokale/tradicionale të cilat lidhen me paganizmin dhe religjionin

- Festimi i Ditës së “**Shën Vasilit**” si fillim i vitit të ri
- Festimi “**Bibiyaki rat**”, Nata e hallës “Kali Sara”
- 5 maji - **Hederlezi**/ Shëngjergji
- 23 maji - **Hedernebiri** – Dita e Bajrakut në lagjën Terzimahallë në Prizren
- 28 qershori - “**Piri**”/ Dita e Farkatarëve Romë

## Ngjarjet zhvillimore të romëve në Kosovë

- 1969 – Formimi i shoqatës kulturo-artistike “Durmish Asllano”
- 1986 – Fillimi i emisionit të parë në botë në gjuhën rome në RTP - Radio Televizioni i Prishtinës
- 1986 – Mësimi plotësues në gjuhën rome në disa komuna të Kosovës
- 1989 – Formimi i teatrit rom në Prizren
- 1992 – Adaptimi i abecedës në gjuhën rome në Prizren nga aktivistet romë
- 2003 – Formimi i redaksisë rome në RTK - Radio Televizioni i Kosovës
- 2007 – Hapja e radios 24 orëshe “Radio Romano Avazo” në Prizren
- 2010 – Fillimi i mëimit fakultativ në gjuhën rome në shkollat fillore në Prizren
- 2011 – Fillimi i transmetimit të edicionit të parë të lajmeve në gjuhën rome në RTK
- 2016 – Graçanica, komuna e parë në Kosovë që e njih gjuhën rome si gjuhë zyrtare
- 2022 - Prizren, komuna e dytë në Kosovë që e njih gjuhën rome si gjuhë në përdorim zyrtarë



# Përfundimi i diskriminimit kundër komunitetit rom në Kosovë

Diskriminimi ndaj komunitetit rom në Kosovë është një çështje e përhapur që kërkon vëmendjen dhe veprimin tonë kolektiv. Diskriminimi është trajtimi i padrejtë i individëve ose grupeve bazuar në racën, përkatësinë etnike, fenë ose statusin e tyre shoqëror. Në Kosovë, komuniteti rom është përballur me diskriminimin, përjashtimin dhe marginalizimin historik.

## Pse duhet të kujdesemi?

Komuniteti rom është pjesë integrale e strukturës së ndryshme kulturore të Kosovës. Për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, ne duhet të trajtojmë diskriminimin dhe të sigurojmë që të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta.

## Çështjet kryesore me të cilat përballlet komuniteti rom:

**Qasje e kufizuar në arsim:** Shumë fëmijë romë përballen me pengesa për arsim cilësor, gjë që kufizon perspektivat e tyre në të ardhmen.

**Papunësia:** Nivelet e larta të papunësisë brenda komunitetit rom kontribuojnë në varfërinë dhe përjashtimin social.

**Pabarazitë në kujdesin shëndetësor:** Qasje në kujdesin shëndetësor është shpesh i kufizuar, duke çuar në rezultate më të dobëta shëndetësore.

**Sfidat e strehimit:** Strehimi nën standard dhe kushtet e papërshtatshme të jetesës janë të zakonshme, duke përjetësuar pabarazitë sociale.

**Stereotipet kulturore:** Paragjykimet dhe stereotipet kundër komunitetit rom i marginalizojnë më tej ata.

## Marrja e veprimeve

**Mbrojtja ligjore:** Kosova ka ligje kundër diskriminimit. Raportoni çdo incident diskriminimi tek autoritetet përkatëse.

**Arsimi:** Mbështetni nismat që ofrojnë arsim cilësor për fëmijët romë dhe nxisin përfshirjen në shkollat e zakonshme.

**Mundësitë e Punësimit:** Avokoni për politika që nxisin punësimin, sipërmarrjen dhe formimin profesional të romëve.

**Qasja në kujdesin shëndetësor:** Puna për të siguruar që komuniteti rom të ketë akses të barabartë në shërbimet e kujdesit shëndetësor.

**Përmirësimet e Strehimit:** Mbështetni iniciativat për strehim adekuat dhe kushte të përmirësuara të jetesës për romët.

**Informimi i komunitetit:** Përfshihuni në programe të bazuara në komunitet që nxisin mirëkuptimin, dialogun dhe thyerjen e stereotipeve.

# Anti-diskriminimi

## Çka është diskriminimi?

**Diskriminimi** ([lat.](#) Discriminatio në kuptimin nënvendosje), dhënia pa ndërgjegje e përparësisë në sjellje.

Në [sociologji](#), me diskriminim nënkuptojmë zhvlerësimin e një grupi të huaj, e në veçanti të një minoriteti shoqëror brenda një shoqërie të ngritur mbi parimet e barazisë, parimit të ndalimit të dallimeve racore, fetare, politike. Diskriminimi është trajtimi i padrejtë ose paragjykes i njerëzve dhe grupeve bazuar në karakteristika të tilla si raca, gjinia, moshë ose orientimi seksual. Diskriminimi ka ekzistuar gjatë, e vazhdon të ekzistoj edhe sot. Njeriu krijoi ligje dhe norma juridike, pra, krijoi të drejtën në bazë të të cilave do të funksionojë sistemi shoqëror dhe politik. Ka pasur raste kur ligjet kanë qenë diskriminuese ndaj grupeve të ndryshme shoqërore si: pakicat kombëtare ose gjuhësore.

## Llojet e diskriminimit

1. Diskriminimi individual
2. Diskriminimi institucional
3. Diskriminimi kolektiv
4. Diskriminimi strukturor
5. Diskriminimi i drejtpërdrejtë
6. Diskriminimi indirekt
7. Diskriminimi negativ
8. Diskriminimi pozitiv
9. Racizmi
10. Seksizmi
11. Diskriminimi i lehonisë
12. Diskriminimi fetar
13. Diskriminimi i moshës
14. Diskriminimi për shkak të paaftësisë ose sëmundjes
15. Diskriminimi bazuar në pamjen fizike
16. Diskriminimi transgjinnor
17. Diskriminimi bazuar në ideologjinë politike

<sup>1</sup> [Diskriminimi - Wikipedia](#)

<sup>2</sup> [16 llojet e diskriminimit \(dhe shkaqet e tyre\) -Psikologji -2023 \(warbletoncouncil.org\)](#)

## a) Diskriminimi i drejtpërdrejtë

Në identifikimin e ankesës për diskriminim të drejtpërdrejtë elementet në vijim duhet të ekzistojnë:

- i/e trajtuar më pak favorshëm
- se dikush tjetër trajtohet, ka qenë apo do të ishte trajtuar
- në një situatë krahasuese
- bazuar në një apo më shumë baza

**= diskriminim të drejtpërdrejtë**

## b) Diskriminim i tërthortë

Diskriminimi i tërthortë shfaqet kur:

- në shikim të parë një dispozitë, kriter apo praktikë neutrale
- vë personat
- në një apo më shumë baza të mbrojtura
- në një disavantazh të veçantë
- në krahasim me personat e tjerë

*Përveç nëse kjo dispozitë, kriter apo praktikë:*

- justifikohet objektivisht me një qëllim legjitim
- masat për arrijten e atij qëllimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme

**= diskriminim të tërthortë**

## Diskriminimi në Kosovë

Diskriminimi në Kosovë është i ndaluar mbi katërmbëdhjetë baza duke përfshirë edhe diskriminimin në bazë të gjinisë. Kjo bazë është e përfshirë në Ligjin Kundër Diskriminimit të vitit 2004 dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila parasheh që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e barazisë dhe të mos diskriminimit. Përveç kësaj, konventat ndërkombëtare siç janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) dhe Konventa për Mënjanimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), të cilat janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë, e ndalojnë një diskriminim të tillë.

<sup>3</sup> [Raporti Final.pdf \(yih-ks.org\)](#)

<sup>4</sup> [Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut –Kosovë dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës denojnë diskriminimin gjinor në Kosovë -Youth Initiative for Human Rights \(yih-ks.org\)](#)

## Si ta parandalojmë diskriminimin?

### Si të parandaloni diskriminimin e racës dhe ngjyrës në vendin e punës:

- Respektoni dallimet kulturore dhe racore në vendin e punës.
- Jini profesionist në sjellje dhe të folur.
- Refuzoni të iniconi, të merrni pjesë ose të falni diskriminimin dhe ngacmimin.
- Shmangni humorin ose shakatë fyese me bazë racore ose kulturore.

### Si mund t'i mbështesni të tjerët për të promovuar barazinë dhe të drejtat?

Kjo do të thotë:

- Vendorsja e rregullave të qarta në lidhje me mënyrën se si njerëzit duhet të trajtohen.
- Sfidimi i çdo qëndrimi negativ.
- Trajtimi i të gjithë stafit dhe studentëve në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.
- Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse për stafin dhe studentët.
- Shmangia e stereotipeve në shembuj dhe burime.
- Përdorimi i burimeve me tema multikulturore.

### Si i promovoni mundësitë e barabarta?

Identifikoni dhe parandaloni paragjykimet e pavetëdijshme. Të gjithë kemi paragjykime të pavetëdijshme.

- Vendorsja e politikave të barazisë.
- Kini parasysh gjuhën tuaj.
- Përdorni kritere objektive.
- Jini proaktiv.
- Merrni këshilla nëse është e nevojshme.
- Kujdes nga diskriminimi indirekt.

## Burimet dhe Referencat

Ligji Kundër Diskriminimit në Kosovë (Ministria e Drejtësisë, Kosovë)

OJQ-të lokale dhe organizatat e komunitetit që punojnë për të drejtat e romëve (Lista e organizatave të disponueshme përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Administratës Publike)


Agjencitë qeveritare që promovojnë përfshirjen dhe barazinë (Ministria e Pushtetit Lokal dhe Administratës Publike)

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë - "Promovimi i përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali në Kosovë" ([www.ks.undp.org](http://www.ks.undp.org))


Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës ([www.ombudspersonkos.org](http://www.ombudspersonkos.org))

## Konkluzioni

Përfundimi i diskriminimit ndaj romëve në Kosovë nuk është vetëm një imperativ moral; është vendimtare për rritjen dhe prosperitetin e të gjithë shoqërisë. Le të punojmë së bashku për të siguruar që çdo qytetar në Kosovë, pavarësisht nga përkatësia etnike, të gëzojë të drejta, mundësi dhe dinjitet të barabartë.



**Ky material nuk paraqet  
qëndrimet e donatorit.**





Kjo broshurë është botuar në kuadër të projektit:  
**"Promovimi i diversitetit dhe gjuhës rome në komunën e Prizrenit dhe fushata ndërgjegjësuere për luftimin e diskriminimit"** të zbatuar nga koalicioni i organizatave rome dhe të mbështetur nga Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianve.

Platforma kombëtare për mbrojtje nga  
diskriminimi për komunitetet  
Rom, Ashkali dhe Egjiptian

<https://www.raportodiskriminimin.org/>

